



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 12/10/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 07/10/2020 të parashtruar nga Kompania e Sigurimeve “Besa Security” SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Mirëmbajtja dhe rregullimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në Gjimnazin Ulpiana Lipjan -Kontratë tre vjeqare me nr te prokurimit 313-20-5201-236 nxjerr këtë ;

### VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pabaze, e Operatorit Ekonomik Kompania e Sigurimeve “Besa Security” SH.P.K pjesëmarrës në tenderin me titull: “Mirëmbajtja dhe rregullimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në Gjimnazin Ulpiana Lipjan - Kontratë tre vjeqare me nr te prokurimit 313-20-5201-236

**Vërtetohet vendimi i AK për [dhënien e kontratës të publikuar me datë: 06/10/2020;**

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Kompania e Sigurimeve “Besa Security” SH.P.K, me datë 07/10/2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Mirëmbajtja dhe rregullimi i sistemit të alarmit publik (kundër thyerjes dhe vjedhjes) në Gjimnazin Ulpiana Lipjan - Kontratë tre vjeqare me nr te prokurimit 313-20-5201-236 ; **me Nr. te brendshëm të prokurimit: 613 20 095 236**. Autoriteti Kontraktues, me datë 10/10/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe gjatë vlerësimit AK ka zbatuar me përpikëri dispozitat nga LPP dhe rregullat e nxjerra nga KRPP

Siç jeni njoftuar edhe me letren standarde ju keni ofruar një deklaratë se selia e juaj gjendet në rr. "Lidhja e Prizrenit" nr 102 por siç është cekur edhe në letren standarde nuk keni ofruar dëshmi se jeni pronar apo e keni me qera edhe pse kemi kërkuar me letër standarde që të dokumentoni se keni zyrë në afersi të shkollës deri në 5km. Gjithashtu në certifikaten e regjistrimit të bizneset që e keni ngarkuar në sistem janë të regjistruara filialet nëpër disa qytete të Kosovës por jo edhe në Lipjan . ne kemi kërkuar edhe në adresën elektronike që ju e keni dhënë <https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1.38.62750> por siq shihet në kopjen e shtypur e cila i bashkangjitet këtij Vendimi nuk është gjetur asnjë e dhënë.

Përveq kësaj ne përsëri ishim te lokali që ju e keni ofruar kontratën se e keni me qera por aty është argjentari siq shihet në foto kurse brenda nuk kishte asnjë shenjë se ka diqka tjetër qoftë kompjuter apo ndonjë dëshmi se mund të ketë edhe një veprimtari përveq argjentarisë edhe pse nuk na është lejuar që ta fotografojmë brenda , kjo na bënë të kuptojmë se kjo kontratë se e keni lokalin me qira që është prezentuar me kërkesen për rishqyrtim është pasi që e keni pranuar letren standarde se oferta juaj është refuzuar. Siç është cekur edhe në letren standarde ai lokal të cilën ju pretendoni se e keni në shfrytëzim është shumë hapsirë e ngusht për një veprimtari e jo për dy veprimtari ne e dijmë se ai lokal ka kohë që është lokal i argjendarisë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Adem Duriqi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit





## Qeveria e Kosovës - Ministria e Financave dhe Transfereve

## LIPJAN

## URDHER BLERJE

|                             |                                                                               |           |            |
|-----------------------------|-------------------------------------------------------------------------------|-----------|------------|
| PËR:                        | <b>VËMENDJE</b>                                                               |           |            |
| ART NET SHPK                | Numri i Urdhër Blerjes duhet të paraqitet në të gjitha faturat koresponduese: |           |            |
| ID E PËRFITUESIT: 810200808 | NR I URDHËR BLERJES: 2020-42442                                               | DATA:     | 13/10/2020 |
| KONTAKTI:                   | NR. I KËRKESËS: 2020-45046                                                    |           |            |
|                             | NR. I OBLIGIMIT: 2020-138490                                                  | NR.ZOTIM: |            |
| TELEFON:                    | Kushtet:                                                                      |           |            |
| Zyrë:                       | KUSHTET E DËRGESËS:                                                           |           |            |

|                    |                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|--------------------|----------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| ADRESA E DËRGIMIT: | KËRKUESI:<br>ADMINISTRATA-LIPJAN | Dokumentet në vijim formojnë një pjesë të kësaj<br>UB:<br>(ju lutem shënoni në përputhje me rrethanat)<br><br><input type="checkbox"/> Kërkesë për kuotim numri I faqeve ?<br><input type="checkbox"/> Letër kuotimi<br><input type="checkbox"/> Kushtet dhe termet gjenerale<br><input type="checkbox"/> Kontrata |
|                    | KONTAKTI                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|                    | TELEFON FAX                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Zyrë:              |                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Mobil:             |                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |

| Artik<br>ull | Përshkrim i artikullit / Blloku kodues | Datat e dërgesës |            | Njësi | Sasia | Cmimi i<br>njësisë | Shuma (?) |
|--------------|----------------------------------------|------------------|------------|-------|-------|--------------------|-----------|
|              |                                        | Nga              | PËR        |       |       |                    |           |
| 1            | # 977 MIREMBAJTJA E TI                 |                  |            |       |       |                    |           |
|              | 10/613/16303/14040/00000/0133          | 1/10/2020        | 31/10/2020 | COPE  | 1.00  | 795.84             | 795.84    |
| TOTAL(?)     |                                        |                  |            |       |       |                    | 795.84    |

## INSTRUKCIONE SPECIALE :

Menaxher i prokurimit:

Nënshkrim:

DATA:

## Udhëzime për përfituesin:

- Ju lutemi dorëzoni mallrat në bazë të udhëzimeve si më lartë
- Kërkesa juaj për pagesë do të drejtohet nga Autoriteti kontraktues në të shkruar dhe do të shoqërohet me faturat që përshkruajnë shërbimet tuaja të punës së realizuar duke përfshirë dokumentet transportuese të dorëzuara dhe kjo do të kompletetohet pasi të gjitha obligimeve të përshkruara në Kërkesën e kuotimit të cmimeve
- Ju lutem na informoni se ju keni pranuar këtë Urdhër blerje brenda 5 (pesë) ditëve që nga data e pranimit.

Nënshkrimi dhe dorëzimi i UB nga Përfituesi :

Emri Mbiemri :

Nënshkrim :

DATA :

URDHER BLERJE

2020-42442







